

Fejton: “Pavarësia dhe fati i minoriteteve (1991-1992)” (7)

Karaxhiq - lideri i racizmit serb në Bosnjë

“Sot serbët nuk mund të jetojnë me kombe të tjera”, i pat thënë Radovan Karaxhiqi ambasadorit amerikan, Warren Zimmerman, në vitin 1992. “Ata duhet të ekzistojnë ndaras. Janë racë e luftës dhe duhet të besojnë se vetëm me luftë mund ta marrin atë që u takon”

Kur Izetbegoviqi u bë president i Bosnjës, më 1990, Deklarata islamike i çonte ujë mullirit serb të propagandës. Serbët e Bosnjës e quanin Izetbegoviqin fundamentalist që synonte t'i fuste ata nën legjislacionin islamik. Shkruesit serb ndanin fraza nga Deklarata për të “treguar” se “Izetbegoviqi ishte dorë e djathtë e Homeinit dhe se Deklarata ishte një ‘Mein Kampf’”.

Partia e Aksionit Demokratik ishte e orientuar nga feja dhe kjo shtyri një anëtar të hershëm të kësaj partie, Adil Zulfikarpashiq, të formonte një parti më sekulare.

Izetbegoviqi bëri edhe budallallëqe të tjera që u shkonin për shtat kundërshtarëve serbë, si vizita në Turqi (’91), ku kërkoi që Bosnja t'i bashkohej Organizatës së Shteteve Islamike; pastaj audiencës islamike në diasporë, ai preferonte t'ua theksonte “nevojën e myslimanëve të Bosnjës për ta pasur një shtet të vetin”; pranoi çmimin e Fondacionit të Mbretit Faisal për shërbime ndaj islamit (93) dhe vizitoi Mekën (94).

Mirëpo ishte ai që bashkë me Kiro Gligorovin e Maqedonisë udhëhoqën përpjekjet për formimin e Jugosllavisë së riorganizuar si një shtet civil. Kjo qe përpjekje e dështuar për t'iu kundërvënë misionit të Milosheviqit për të serbizuar Jugosllavinë. Momentet kritike para fillimit të luftës

ishin kur Kroacia dhe Sllovenia (1990) morën qëndrim se Jugosllavia duhet të jetë konfederatë e shteteve sovraane, me fjalë tjera, i kënaqte vetëm pavarësia. Në këtë pikë Bosnja kishte vetëm dy zgjidhje: të pajtohej me shkëputjen e këtyre dy vendeve dhe të rrinte në Jugosllavinë e dominuar nga serbët, ose ta krijonte një shtet të pavarur, të përbërë nga tri grupe etnike thellë të përçara. Këtë gjendje, Izetbegoviqi e karakterizoi si zgjedhje mes leucemisë dhe tumorit në tru.

Në qershor të 91-s, Zulfikarpashiqi and Muhamed Filipoviqi negociuan një marrëveshje me Radovan Karaxhiqin dhe liderët serbë që Bosnja të mbetej shtet sovran dhe i pandarë në kuadër të Jugosllavisë së rifederalizuar, të përbërë nga tre popuj shtetformues. Sipas Zulfikarpashiqit, Milosheviqi qe pajtuar me këtë plan se do t'ia siguronte Bosnjës 60 për qind të Sanxhakut dhe autonominë për pjesën tjetër të rajonit.

Kjo do të kishte rëndësi të madhe për myslimanët jugosllavë pasi edhe pse do të dominohej nga serbët, Federata e re në vete do të përfshinte myslimanët që jetonin në Kosovë, Maqedoni, Sanxhak e Mal të Zi, sikurse edhe në Bosnjë dhe, eventualisht, myslimanët do të bëheshin forcë politike.

Por Izetbegoviqi frikësohej se në Jugosllavinë me Milosheviqin në krye,


boshnjakët do të ishin qytetarë të dorës së dytë, ndërsa pjesët kroate të Hercegovinës, do t'i bashkoheshin Kroacisë.

Mosinteresimit të Izetbegoviqit për perspektivën e krijimit të një entiteti mysliman në Jugosllavi, i kontribuan kontaktet e tij me disa të burgosur shqiptarë. “Feja është e padobishme për popullin tonë dhe luftën e tij për liri”, i kishte thënë atij një lider kosovar.

Izetbegoviqi ishte shumë i matur për të qenë dinamik si lider, që nuk mund të thuhet për armiq të tij, Karaxhiqin, Milosheviqin dhe Franjo Tuxhmanin. Ish-ambasadori amerikan në Jugosllavi, Warren Zimmerman Izetbegoviqin e shihte si të moderuar Karaxhiqin e konsideronte tip konfliktuoz, të cilit “mendja e bërë top në ndjekjen e agjendës radikale serbe i kombinohej me armiqësinë e thellë e të ngulitur, madje edhe racizëm ndaj myslimanëve, kroatëve dhe grupeve të tjera joserbe në fqinjësi”.

“Sot serbët nuk mund të jetojnë me kombe tjera”, i pat thënë Karaxhiqi Zimmermanit në vitin 1992. “Ata duhet të ekzistojnë ndaras. Janë racë e luftës dhe duhet të besojnë se vetëm me luftë mund të marrin atë që u takon”.

Karaxhiqi dhe partia e tij filluan të minojnë strukturën e brishtë të shtetit të Bosnjës, duke krijuar tri “rajone autonome serbe”, armatosnin me elemente serbizmi



Ish-ambasadori amerikan në Jugosllavi, Warren Zimmerman Izetbegoviqin e shihte si të moderuar Karaxhiqin e konsideronte tip konfliktuoz, të cilit “mendja e bërë top në ndjekjen e agjendës radikale serbe i kombinohej me armiqësinë e thellë e të ngulitur, madje edhe racizëm ndaj myslimanëve, kroatëve dhe grupeve të tjera joserbe në fqinjësi”

pjesëtarët e UJ-së në Bosnjë dhe krijuan legjislacionin e tyre.

(Nesër: Si e inkurajonte Milosheviqi Karaxhiqin? Cili ishte qëllimi i Tuxhmanit? Pse ishin pothuaj të njëjtë Tuxhmani dhe Karaxhiqi?)

Fejton: “Al Capone: kumbara i nëntokës” (9)

Bota e vogël

Al Capone u kthye në Chicago dhe para derës po e prisnin gjashtë policë që ia kishin drejtuar në fytyrë tytat e çifteve të gjuetisë. “Ç’po ju duhet gjithë kjo artileri”, u tall Capone me ta

Al Capone e kishte vajtuar shokun e tij të vrarë Theodore Anton të njohur me nofkën Greku Toni.


Ndërkohë, kishte nisur të fliste publikisht se kishte ardhur koha të tërhiqej nga bizneset ilegale. Madje, për ta dëshmuar këtë i kishte ftuar në shtëpinë e tij gazetarët më të shquar të

Chicagos dhe u kishte përgatitur shpageta. Me fjalë të tjera, bëri të ditur se nuk do t'i ndiqte ata që e kanë vrarë Grekun Toni. Derisa ai po mendonte seriozisht për të dalë në pension në moshën 28-vjeçare, Chicagoja, më shumë se kurrë, ishte bërë vend i përshtatshëm për një gangster. Prefekti Dever e kishte marrë pushtetin më së shumti në saje të fondeve të siguruar nga mafia.

Megjithatë, hyqymeti i kishte shpresat te një njësit special i zbulimit, i udhëhequr nga Elmer Irej, i cili i kishte zënë edhe disa gangsterë më të vegjël dhe tani ia kishte mësyre Al Capones. Al Capones nuk i bëhej vonë. E vazhdonte biznesin (megjithë idetë për pensionim) dhe kishte nisur të interesohej në dy pasionet e tij më të mëdha: muzikën dhe boksën. Ishte bërë shok i ngushtë me kampionin e boksit në kategorinë e rëndë Jack Dempsey, ndërsa nuk linte asnjë operë pa e përcjellë në premierë. Po ashtu, ishte adhures i madh i xhazit.

Megjithatë, bota ishte bërë e vogël për të dhe këtë e mësoi kur udhëtoi në Los Angeles, ku shefi i policisë e prit me fjalët: “Nuk pranojmë gangsterë në këtë qytet”. Më mirë nuk gjet as kur u kthye në Chicago.

Gjashtë policë të armatosur me



Al Capone në ballinën e revistës Time të datës 24 mars 1930

çifte po e prisnin te dera.

“Dreqi më marrtë! Thashë mos jam Jesse James! Ç’po ju duhet gjithë kjo artileri?” - ishte tallur Capone me policët.

Mirëpo, policët nuk do talinin rehat asnjë ditë dhe ai vendosi të ikte në Miami së bashku me gruan Mae dhe të birin Albertin. E bleu një shtëpi me 14 dhoma në Palm Island. Në Miami, Al

Capone po sillej në qarqet e njerëzve të ndershëm, ndërsa vazhdonte nga distanca t'i udhëhiqte bizneset e shtëpive publike, të kazinove dhe të kontrabandës me alkool. Mirëpo, dikush po ia vidhte një sasi të alkoolit atje larg në Chicago. Al Capone dyshonte mos pas shpine po ia punonte partneri i tij Frankie Yale.

Gangsterë të tjerë të shquar

Victor Bout

Victor Bout konsiderohet kontrabanduesi më i madh i armëve në botë dhe është 38-vjeçar. Bout është i lindur në Taxhikistan dhe ka mbaruar shkollën ushtarake në Moskë. Ka qenë instruktor i komandosëve në ushtrinë e Rusisë. Flet rrjedhshëm 6 gjuhë të huaja. E ka shfrytëzuar rastin pas shpërbërjes së BRSS-së dhe ka nisur të shesë armatim për grupe të ndryshme militare në botë. Gjatë periudhës 92 - 95 i ka fituar 50 milionë dollarë nga shitja e armëve në Afganistan. Më pas ka shitur armë në Kamerun, në Keni, në Angolë, në Afrikën Qendrore, në Liberi, në Ruandë, Sierra-Leone, Afrikë të Jugut, Sudan e Ugandë.

Pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit në Amerikë, njësitet e zbulimit amerikan u hodhën pas Boutit, sepse ai i kishte furnizuar me armë grupet afgane që ishin të afërta me Osama Bin Ladenin. Mirëpo, katër vjet më pas, Victor Bout është ende i lirë.

(Në numrin e nesërm: A e kishte mashtruar vërtet Frankie Yale Al Caponen? Cila ishte thirrja e kobshme telefonike? Kur u shfaq Bugs Moran, partneri i të ndjerit Hymie Weiss?)

Më pranë, me mundësitë tona

WESTERN UNION

KOSOVË
+381 38 549 840
+377 44 110 840

GJERMANI
0180 30 40 500
0180 522 58 22
0180 521 77 21

ZVICËR
0180 30 40 500
0180 522 58 22
0180 521 77 21